



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 126, datë 27.10.2022

PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË
RINDËRTIMIT

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të proçesit të rindërtimit”, Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak Durrës si edhe sipas relacionit të 2 komisioneve të përhershëm të këshillit, me propozim të Komisionit të Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së përfituesve nga programi i proçesit të rindërtimit pallati 1062, sipas Relacionit të hartuar nga Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, për:
 - a. Gëzim Peza (ID G00809074A) dhe Fatime Peza (ID G25525219E), strukturë 1+1.
 - b. Ardian Peza (ID I70704072G), Nidja Peza (ID J15304087A), Olivia Peza (ID M05220031T), (në ngarkim Xheni Peza ID J35723061B), strukturë 2+1.

2. Mospërputhjet midis sipërfaqes dhe strukturës me ish-banesat, që zotëronin të trajtohen sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për strehimin.
3. Çdo vendim tjetër që trajton me strukturë banimi ndryshe këta shtetas shfuqizohet.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 28.10.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 834 / prot.

Durrës, më 08 / 11 / 2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.126 datë 27.10.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit”

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

